



Republika e Kosovës
Republika Kosova **Republic of Kosovo**

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-0/DPK
 Nr. Prot. 01-686/15
 Prot. No. 03
 Data 09.03.2015
 PRISHTINË

DATE/A:	06.03.2015
REFERENC-Ë:	DPK- DPKPP-03-03/583/15
PËR/ZA/TO:	z. Selami BERISHA Udhëheqës i Divizionit të Prokurimit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
CC:	z. Nazmi ZENELAJ Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Fushata Promovuese për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë "

I nderuari z. Berisha ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Fushata Promovuese për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë " me numër prokurimi: 43800-15-011-221, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin " Fushata Promovuese për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë " me numër prokurimi: 43800-15-011-221, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m i

Ministria e Zhvillimit Ekonomik si Autoriteti Kontraktues, përmes Divizionit të Prokurimit ka iniciuar procedurën e prokurimit me titull " Fushata Promovuese për Eficiencë të Energjisë dhe Burime të Ripërtëritshme të Energjisë " me numër prokurimi 43800-15-011-221, e cila është publikuar në faqen elektronike të KRPP-së me dt.25.02.2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë të llojit shërbime me vlerë të mesme.

Agjencia kundër Korrupsionit, sipas detyrës zyrtare ka identifikuar dhe trajtuar këtë procedurë të prokurimit. Gjatë shqyrtimit dhe ekzaminimit të dokumenteve në dispozicion për këtë tender, AKK ka hasur në disa kërkesa të cilat janë në kundërshtim me Legjislacionin në fuqi i cili e rregullon fushën e Prokurimit Publik në Republikën e Kosovës.

Në njoftimin e publikuar për kontratë dhe në dokumentet e dosjes së tenderit tek rubrika 8.1 Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare pika 1 janë kërkuar pasqyrat financiare të hartuara nga një kompani ose auditor i licencuar për tre vitet e kaluara kërkesë kjo për të cilën konsiderojmë se bie ndesh me LPP-në. Autoriteti kontraktues mund të kërkojë kopje të pasqyrave në të ardhura dhe raporte të menaxhmentit të certifikuara nga një kompani e licencuar e auditimit me reputacion, **por nuk është e lejuar që të pranohet edhe raporti auditimit nga një Auditor edhe nëse ai është i licencuar pa u kërkuar i njëjti nga Kompania e licencuar e auditimit me reputacion.**

Tek rubrika 9.1. e Kapacitetit teknik dhe profesional 1. Autoriteti Kontraktues ka kërkuar Minimum listën me tri kontrata me Autoritete të ndryshme të cilat kanë të bëjnë projekte të cilat merren me lëmi të ngjashme për eficienten e energjisë, të njëjtave kontrata duhet të i'u bashkëngjiten edhe referencat e vulosura nga Autoriteti Kontraktues për projektet e kryera nga Llojin e shërbimeve të përfshira. Shumën e kontratës, dhe Datën dhe pranuesin, kërkesë kjo për të cilën gjithashtu konsiderojmë se është në kundërshtim me Ligjin Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik.

Autoriteti kontraktues ka të drejtë që në kuadër të kriterëve të përzgjedhjes të kërkojë, kontrata dhe referenca për punë të ngjashme në tri vitet e fundit për ta vërtetuar aftësinë teknike ose profesionale të Operatorëve ekonomik. Në qoftë se Autoriteti kontraktues kërkon kontrata dhe referenca për ta vërtetuar aftësinë teknike dhe profesionale të OE-ve, atëherë detyrimisht këto kontrata dhe referenca duhet ti kërkojë në tri vitet e fundit (2011,2012 dhe 2013) në pajtim me Legjislacionin e aplikueshëm për Prokurimin Publik.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi, nenin 68 Gjendja Ekonomike dhe Financiare të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042, nenin 23 Kriteret e përzgjedhjes e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia kundër Korrupsionit rekomandon anulimin e kësaj procedure të prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

